



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

05 Nr. 1027 / 2011

Data : 19.12.2011

Në bazë të nenit 4.1 dhe nenit 5 pika c dhe d të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 3/2009 për procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpall :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

-I- Shkolla Fillore "Mulla Idriz Gjiçani" në fsh. Velekincë

- Pozita : Drejtor i Shkollës

Përshkrimi i punëve : Udhëheqë institucionin dhe është përgjegjës për :

-Zbatimin e ligjshmërisë,

-Planifikimin,udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në Institucion,

-Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe aftgjatë për aktivitetin e Institucionit.

Kushtet :

- Të jenë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer njërin nga fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës ose të fakulteteve private të akredituara dhe të licencuara nga MASHT,
- Të kenë më së paku 3 (tri) vite përvojë pune në arsim.

Dokumentet e nevojshme: Certifikata e lindjes, diploma e fakultetit të kryer, kopja e letërnjoftimit, dëshmia për përvojën e punës, CV-në sipas modelit të MASHI-it, Certifikatat e trajnimeve të zhvilluara, programin zhvillimor të Institucionit për të cilin ka konkurruar (në më së shumti pesë faqe tekst me 30 rreshta të letrës të formatit A4), rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibil si dhe Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet nuk do të shqyrtohet. Në intervistë do të ftohen kandidatët nga lista e ngushtë.

Koeficienti 7.8

Kohëzgjatja e kontratës: sipas udhëzimit administrativ 3/2009

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Drejtori
Bujar Nevzati